**Njoftim per konsultim publik**

**Bashkia Kolonje, data 28.10.2022, ora 13.00, salla e Bibliotekes se Qytetit Erseke**

**Titulli**: Mbledhja e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për projekt buxhetin afatmesem 2023 – 2025

**Propozuesi**: Projekt akti është propozuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Isai

**Sqarime per projekt aktin**: Relacioni sqarues i projekt aktit percakton arsyet e paraqitura nga propozuesi i projekt aktit te cilat ne menyre te permbledhur jane:

- ***Nevojat e komunitetit per permiresimin e sherbimeve publike bazuar ne buxhetin 23-25***

**Kalendari i konsultimit**: Konsultimi publik do te realizohet në **Kolonje/Erseke, data 28.10.2022, ora 13.00, salla e Bibliotekes se Qytetit Erseke.**

**Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linqet e mëposhtëm:**

https://www.kolonja.gov.al/kolonje-plani-i-performances-23-25/

dhe linkut PBA Kolonje 2023-2025
https://www.kolonja.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/PBA-2023-2025-FINAL-Ripunuar-B.Kolonje-1_compressed.pdf

**Pjesemarres:**

- **Nga ana e Bashkise dhe e keshillit bashkiak**: Kryetari i Keshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkise, Kryetari i Komisionit te Ekonomise dhe Finances te Keshillit te Bashkise, Kryetarja e Aleances se Grave Keshilltare, Koordinatori per Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Zyra e Finances se bashkise, Keshilltare.
-
- **Nga komuniteti**: Banorë te bashkise Kolonje, banore dhe perfaqesues nga NJA, kryepleq te fshatrave, perfaqesues nga institucionet, perfaqesues nga biznesi, OJF, etj

- **Forma e konsultimit:** Takim publik

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | 1. Prezantimi i instrumentave te komunikimit te Keshillit Bashkiak me qytetaret.<br>2. Evidentimi i nevojave te komunitetit per permiresimin e sherbimeve publike bazuar ne buxhetin e 23-25 |

| | |
|---|---|
| | |
| Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm | Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizoje këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2022, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e cila komuniteti përzgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme. |
| Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut | Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me cështjet si vijon :<br>1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë?<br>2. Cilat jane nevojat tuaja per te cilat duhen permiresuar sherbimet nga ana e Bashkise?<br>3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2023 – 2025?<br>4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur?<br>5. Tjetër |
| Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet | Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:<br>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin |

| | |
|---|---|
| nga publiku deri në marrjen e vendimit | të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;<br>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomise dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;<br>3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (**mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar)** të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;<br>4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor;<br>5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në **seancën e hapur** të Mbledhjes së Këshillit;<br>6. **Informimi i komunitetit,** për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;<br>7. **Publikimi** i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;<br>8. **Njoftimi** i administratës për aktin e miratuar;<br>9. **Monitorimi** i zbatimit të tij. |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone :<br>Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia. |
| Kontaktet dhe afatet e degimit te komenteve, rekomandimeve, verejtjeve | Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 25 Nëntor 2022, në adresen e emailit<br>Insuida1999@icloud.com |
| Data e publikimit | 18.10.2022 |